BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

**Titulli:** Zyrtar i Ri për Prokurime
**Departamenti:** Administratës
**Divizioni:** Prokurimet
**Niveli i gradës:** **7**
**I raporton:** Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimeve

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**
Kujdeset dhe asiston në përgatitjen e dokumentacionit për shpalljet e njoftimeve si dhe koordinohet me zyrtarët e prokurimeve për caktimin e afateve kohore në përputhje me rregulloren e prokurimit;

- Asiston në përgatitjen e dokumentacionit për çdo prokurim sipas kritereve të parapara;
- Mban evidencë adekuate të tërë procesit të prokurues për secilin prokurim dhe në bazë të kësaj asiston në përgatitjen e raporteve përkatëse mbi aktivitetet prokuruese;
- Ndihmon zyrtarin e Prokurimeve në përpilimin e kontratave;
- Kujdeset për përgatitjen e hapjeve publike të tenderëve, si dhe përgatitjen e procesverbaleve dhe dokumenteve të tjera përcjellëse;
- Asiston në përgatitjen e raporteve mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore lidhur me prokurimet dhe raporte të tjera lidhur me prokurimet;
- Kryen detyra tjera të lidhura me prokurimet varësisht sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

**Edukimi:**

- Diplomë Universitare në Fakultetin Juridik.
- Njohje e shkëlqyeshme e programeve të MS Office si dhe aftësi të përshtatjes për punët me Sistemin e Menaxhimit te Informacionit

**Përvoja e punës:**

- Së paku 2 (dy) vite përvojë pune profesionale.

**Njohja e gjuhëve te huaja:**

- Rrjedhshmëri në të folur dhe në të shkruar të gjuhës shqipe dhe/ose serbe;
- Njohja e gjuhës angleze e preferueshme.

**Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:**

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente;
- Raporti nga Trusti i cili e dëshmon periudhën kohore të përvojës së punës;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

**Procedura e aplikimit:**

- Afati i fundit për aplikim është **12 korrik 2022.**
- Aplikimi mund të bëhet online (https://hris.bqk-kos.org) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**